

PËRSE HESHT AKADEMIJA E SHKENCAVE TË SHQIPËRISË PËR ÇËSHTJET MADHORE TË KOMBIT?!

Dashamir URUÇI

PËRMBLEDHJE

Shekulli XXI dha sinjalin e nisjes së një epoke të re për çështjen kombëtare. Në saj të qëndrimit të drejtë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Fuqitë e Mëdha europiane e kuptuan se paqja në Ballkan nuk mund të vendoset pa u korrigjuar padrejtësitë e bëra ndaj kombit shqiptar, duke filluar nga Traktati i Shën Stefanit të vitit 1877, në Kongresin e Berlinit qershor 1878 dhe më pas në Konferencën e Ambasadorëve të Londrës 1912-1913. Mirëpo, disa prej tyre ende nuk janë çliruar nga "dashuritë" e vjetra, pasi aleancat legale dhe ilegale vazhdojnë të ruhen dhe shpesh reflektojnë negativisht në zgjidhjen e çështjes sonë kombëtare. Bashkimi i trojeve shqiptare kërkon në radhë të parë ndërgjegjësimin e faktorit shqiptar dhe në mënyrë të veçantë të Tiranës zyrtare. Shqipëria duhet të luaj rolin e koordinatorit për të unifikuar qëndrimin politik, bazuar në një strategji të qartë kombëtare, duke flakur tej interesat e ngushta politike, klanore apo personale. Ne kemi për detyrë të punojmë fort për të realizuar bashkimin shpirtëror, të kemi një abetare, një tekst të gjuhës shqipe, një histori, të bëjmë më shumë shkëmbime kulturore e sportive, të jemi më prezent te njëri tjetri. Të gjitha këto nuk janë thjeshtë punë të qeverisë por dhe të institucioneve tona kulturore, arsimore dhe shkencore. Këto duhet të jenë çështje të mbarë shoqërisë shqiptare. Edhe pse kanë kaluar afër 30 vjet demokraci, ndikimi i politikës së Tiranës zyrtare në trojet shqiptare të mbetura jashtë Shqipërisë Londineze, ka qenë pa rezultate të dukshme. Besimi i politikanëve të këtyre trojeve te politika në Shqipëri, nuk është në nivelin e duhur.

Fjalë kyç: *akademia shkencave, besimi i politikanëve, troje, politika në Shqipëri, shoqëri shqiptare*

HYRJE

Kosova ka mbi 20 vjet e pavarur dhe ende nuk ka shtetin e saj të njohur ndërkombëtarisht. Kufijtë e Kosovës me Serbinë nuk janë saktësuar, për pasojë konfliktet vazhdojnë. Mitrovica ka vite që rri e mbërthyer nga terrori serb. Trepça dhe Ujmani i Mitrovicës, dy asete bazë për mbijetësen e Kosovës, janë ende të ndarë në mes. Kjo tregon se në këtë çështje ka përgjegjësi edhe politika shqiptare, e cila ka bërë pak për të ndërgjegjësuar shtetet që ende nuk e kanë njohur të drejtën për vetvendosje të popullit të Kosovës. Përgjegjësi mban edhe Akademia e Shkencave që duhet t'i tregoj botës se Mitrovica, në fillim të shekullit XX, ka qenë e populluar tërësisht nga shqiptarë. Bashkimi i trojeve shqiptare kërkon në radhë të parë ndërgjegjësimin e faktorit shqiptar dhe në mënyrë të veçantë të Tiranës zyrtare. Shqipëria duhet të luaj rolin e koordinatorit për të unifikuar qëndrimin politik, bazuar në një strategji të qartë kombëtare, duke flakur tej interesat e ngushta politike, klanore apo personale. Ne kemi për detyrë të punojmë fort për të realizuar bashkimin shpirtëror, të kemi një abetare, një tekst të gjuhës shqipe, një histori, të bëjmë më shumë shkëmbime kulturore e sportive, të jemi më prezent te njëri tjetri. Të gjitha këto nuk janë thjeshtë punë të qeverisë por dhe të institucioneve tona kulturore, arsimore dhe shkencore. Këto duhet të jenë çështje të mbarë shoqërisë shqiptare.

1. NDIKIMI I POLITIKËS SË TIRANËS

Edhe pse kanë kaluar afër 30 vjet demokraci, ndikimi i politikës së Tiranës zyrtare në trojet shqiptare të mbetura jashtë Shqipërisë Londineze, ka qenë pa rezultate të dukshme. Besimi i politikanëve të këtyre trojeve të politika në Shqipëri, nuk është në nivelin e duhur. Ata besojnë në këshillat që jep Tirana vetëm kur të shohin një Shqipëri të zhvilluar ekonomikisht, kur politika të qëndrojë larg korrupsionit, kur ajo të zbatohet parimin e reciprocitetit me fqinjët dhe të shkundet nga ndjenja e inferioritetit, kur partitë të ndjekin të njëjtën strategji për të mirën e kombit, kur rinia shqiptare të ketë fituar besimin e politikës, të mos e ketë mendjen për të ikur nga ky vend, por të mendojë çfarë mund të bëjë secili në dobi të atdheut të vet. Qëndrimi i shtetit am, në trajtimin e çështjes çame, ka qenë i vakët. Zyrtarët shqiptarë shpesh herë i janë nënshtruar presionit të politikës greke. Janë nënshkruar dhjetëra marrëveshje me Greqinë, përgjithësisht në favor të Athinës. Është nënshkruar Traktati i Miqësisë, pa kërkuar më parë nga institucionet ndërkombëtare që të ndikonin për heqjen e ligjit të luftës që Greqia ia tund herë pas here Shqipërisë në formë kërcënimi. Është nënshkruar marrëveshja për Detin, në dëm të Shqipërisë, e cila u kundërshtua nga Gjykata Kushtetuese. Po punohet për ta nënshkruar sërish këtë marrëveshje, në konspiracion të plotë, pa transparencën e duhur, e cila nevojitet për t'u shpjeguar shqiptarëve se çfarë po ndodh me territorin e Republikës së Shqipërisë. Shoqëria Civile nuk është informuar rreth përmbajtjes së saj, pasi politika shqiptare hesht. Gjithsesi jemi njohur me deklaratat e kryeministrit dhe të ministrit të Punëve të Jashtme të Greqisë, që thonë se ajo është tërësisht në favor të Athinës zyrtare.

1.2 ÇËSHTJA E SHQIPTARËVE TË MAQEDONISË

Mangësi të politikës zyrtare ka edhe ndaj çështjes së shqiptarëve të Maqedonisë. Qeveria dhe parlamenti maqedon i trajton shqiptarët si pakica kombëtare dhe jo element shtetformues. Nga pala shqiptare është mbajtur qëndrim i zbehtë dhe aspak dinjitoz në rastin kur Akademia e Shkencave të Maqedonisë, në enciklopedinë e vet, i cilëson shqiptarët të ardhur pas sllavëve dhe i paraqit si njerez të egër, të rritur në male, pra njerëz primitiv. Është bërë pak për marrëveshjen e Ohrit, e cila me gjithë mangësitë nuk ka gjetur zbatim. Gjuha shqipe ende nuk është njohur si gjuhë zyrtare. Madje shteti maqedon nënshkroi marrëveshjen e Prespës me Greqinë, për çështjen e emrit, dhe në atë marrëveshje është fshirë e drejta e gjuhës shqipe për të qenë gjuhë zyrtare, krahas maqedonishtes. Madje kemi politikan shqiptar, si Ali Ahmeti, i cili deklaroi në Tiranë, në takimin e diasporës, se gjuha shqipe është tashmë gjuhë zyrtare, kur Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë njeh gjuhë zyrtare vetëm maqedonishten. Përballë kësaj ngjarje me rëndësi të veçantë, nuk kemi asnjë reagim prej Akademisë së Shkencave të Shqipërisë. Në të gjitha shtetet me demokraci të qëndrueshme, por edhe në ato që janë në zhvillim, rol me rëndësi luan Akademia e Shkencave. Akademitë shprehen për të gjitha çështjet me rëndësi të kombit, politike, ekonomike e sociale. Mirëpo Akademia e Shkencave të Shqipërisë, ka rënë në gjum të thellë. Në këto 30 vite nuk ka asnjë deklaratë apo dukument shkencor të rëndësishëm të nënshkruar prej saj lidhur me fatet e kombit shqiptar; nuk kemi asnjë prononcim për çështjen çame, për Mitrovicën, për vijën e demarkacionit me Malin e Zi, për çështjen e kufirit detar me Greqinë, për problemet në Maqedoni, për zhvillimin ekonomik, për bujqësinë e braktisur, për shkatërrimin e zonave turistike me ndërtime pa kriter etj. Me një fjalë, nuk ka asnjë qëndrim të saj për këto dhe shumë çështje të tjera me rëndësi kombëtare, të cilat do t'i vinin në ndihmë qeverisë për të ndërtuar politika më të mira, të jashtme dhe të brendshme, në dobi të së ardhmes së kombit

shqiptar, të zhvillimit ekonomik dhe bashkimit kombëtar. Akademia e Shkencave duhet t'i kundërvihet me forcë ideologjisë së shpërbërjes të kombit shqiptar, të cilën e kanë hartuar dhe venë në zbatim homologët e tyre në Serbi, Greqi, Maqedoni dhe Malin e Zi. Studiuesit dhe shkencëtarët tanë duhet të marrin në mbrojtje në mënyrë të argumentuar rrjedhën tonë ilire, gjuhën tonë të lashtë, traditën dhe historinë tonë kombëtare. Për këtë gjendje të krijuar mban përgjegjësi edhe qeveria, e cila nuk ka mundur t'i jap këtij institucioni rëndësinë e duhur. Nuk ka mundur të bëjë reformën e nevojshme, me qëllim që në karriget e akademikëve të ulen njerëz të ditur e atdhetar, që dëshirojnë të punojnë në dobi të interesave shqiptare.

Në këto kushte, Akademia e Shkencave të Shqipërisë duhet të bashkëveproj me Akademinë e Shkencave të Kosovës, të tërheq mendimin e diasporës shqiptare dhe të vihen në ballë të zhvillimeve që kërkon koha, të zënë vendin që u takon në përpjekje të shqiptarëve për të mbrojtur interesat kombëtare. Mos veprimi është i pafalshëm dhe po e dëmton rëndë çështjen tonë kombëtare. Nga kjo trubunë e këtij kongresi, u bëj thirrje institucioneve shkencore të Shqipërisë, inteligjencës shqiptare, që të ngrihen në këmbë dhe të zënë vendin që u takon në përpjekjet e shqiptarëve për të drejtat e tyre civile kombëtare dhe njerëzore. Akademia e Shkencave jo vetëm që nuk reagon, por edhe kur ka studiues të tjerë që tentojnë të thonë fjalën e tyre shkencore, mbahen larg, madje anatemojnë dhe ironizohen nga ata që janë ngjitur me karrigen e Akademisë dhe nuk duan t'ia dinë për faktin që po luhet me fatin e shqiptarëve në Ballkan. Janë disa vende pune dhe institucione të posaçme, në të cilat duhet të punësohen në radhë të parë njerëz patriotë, të lidhur fort me fatin e vendit të vet dhe në radhë të dytë militantë partie që janë anglishtfolës dhe njohës të mirë të kompjuterit dhe IT-së. Popujt europianë dhe qeveritë e tyre, diplomacinë, shërbimet sekrete, ushtrinë dhe institucionet shkencore, i kanë të servuara për djemtë dhe vajzat e familjeve të sprovuara, në mbrojtje të interesave shtetërore dhe të popullit të vet.

Lahutën e famshme, lahutën e Malësisë, lavden me të cilën në mijëvjeçarë të parët tanë i kënduan lavdisë së heronjëve dhe luftëra për liri, na e morën serbët. Rrjedhën tonë pellazgo-ilire nuk e njohin ende institucionet tona shkencore. Edhe ata pak studiues që flasin i ka mbytur deti i heshtjes dhe mbahen larg nga shteti i së drejtës që duam të ndërtojmë. Gjetjet arkeologjike në Bosnjë, piramidat e famshme ilire atje, gjetjet arkeologjike në ishullin e Konçulit në Kroaci, e kanë çuar kulturën ilire rreth 15 mijë vjet para erës sonë. Dhe në këto konkluzione nuk kanë arritur njerëz do sido, por ekspertë me famë të kësaj fushe. Asnjë ekspeditë nuk kemi nga Akademia e Shkencave të Shqipërisë për t'u njohur me këto zbulime të reja shkencore me vlerë të pallogaritshme për historinë e kombit shqiptar. Të gjithë ata njerëz që kanë patur rastin të marrin pjesë në veprimtaritë e Akademisë së Shkencave, në sfondin përballë sallës, kanë parë emblemën e Akademisë Shqiptare të Shkencave. Në zemrën e kësaj embleme qëndron prej vitesh gërma Sigma, pra shkronja e parë e fjalës Sofi, që në greqisht do të thotë Dituri. Siç shihet, grekët, me politikën e tyre të helenizimit, kanë depërtuar deri në simbolin e institucionit më të lartë të shkencës shqiptare. Të nderuar pjesëmarrës, këto që thashtë në këtë diskutim të thjeshtë midis jush, mund t'i thotë çdo intelektualë apo qytetarë i këtij vendi, pa qenë nevoja të jetë pelazgolog, ilirolog, arkeolog, gjuhëtarë apo historian me famë. Secili prej nesh mund të flasë dhe t'i ngrejë këto probleme, mjafton që ta dojë me shpirt vendin e vet.